


BULETINI TREMUJOR
FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE TË KOSOVËS



TRUSTORJA

PERFORMANCA KUMULATIVE E FKPK-SË PREJ THEMELIMIT



PERIUDHA	1M	3M	1V	3V	5V	NGA THEMELIMI
REZULTATI	+0.30%	+2.16%	+6.48%	+13.74%	+31.14%	+46.48%
BENÇMARKU*	+0.00%	+0.20%	+0.49%	+1.64%	+1.72%	+33.46%

*INDEKSI I HARMONIZUAR I ÇMIMEVE TË KONSUMIT I PUBLIKUAR NGA AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS

PERFORMANCA DHE KTHIMI NGA INVESTIMET

ÇMIMI I AKSIONIT:

TETOR	▲ +1.29%
NËNTOR	▲ +0.55%
DHJETOR	▲ +0.30%
GJITHSEJ PERFORMANCA NETO	▲ +2.16%

KTHIMI BRUTO:

TETOR	+€21.03 mln
NËNTOR	-€9.59 mln
DHJETOR	+€5.52 mln
GJITHSEJ KTHIMI BRUTO	+€36.13 mln

KRYESORET

ÇMIMI I AKSIONIT NË FUND TREMUJORI €1.4648	MJETET NETO NËN MENAXHIM €1,634,648,056
MJETE TË SHPAGUARA KËTË TREMUJOR €6.01 mln	MJETE TË SHPAGUARA KËTË VIT €27.44 mln
TË PENSIONUAR PËR PERIUDHËN 1,068	TË PENSIONUAR PËR VITIN 5,175
LLOGARI TË KONTRIBUESVE 591,527	LLOGARI AKTIVE NË FUND TË PERIUDHËS 352,860
KONTRIBUES TË RINJ KËTË VIT 49,612	KONTRIBUTE TË ARKËTUARA KËTË VIT €159.77 mln
SHËRBIME TË OFRUARA KËTË VIT 143,218	LLOGARI NË TRUSTI 79,867

PLASMANET DHE PERFORMANCA PËR SECILIN MENAXHUES / EMETUES NË KËTË TREMUJOR

MENAXHUESI/EMETUESI	EMRI I FONDIT/INSTRUMENTIT /BANKËS	PLASMANET	PJESËMARRJA	PERFORMANCA	KONTRIBUIMI NË PERFORMANCËN BRUTO TË FKPK
Vanguard	Global Stock Index Fund - Euro	€361,403,004	22.35%	+4.76%	+1.06%
Nordea	1-Stable Return Fund	€241,600,014	14.94%	+1.28%	+0.19%
Nordea	1-Global Stable Equity Fund	€145,628,472	9.00%	+3.04%	+0.27%
BNY Mellon	Global Real Return Fund	€109,129,650	6.75%	+0.26%	+0.02%
AXA	Global Inflation Linked Bonds	€99,809,207	6.17%	+1.88%	+0.12%
AXA	WF Optimal Income I EUR	€108,383,713	6.70%	-0.27%	-0.02%
Pictet	High dividend selection Z EUR	€32,815,554	2.03%	+3.22%	+0.07%
Schroders	ISF Global Diversified Growth	€109,308,172	6.76%	+3.12%	+0.21%
Amundi	Rendement Plus Part I2	€85,394,186	5.28%	+0.82%	+0.04%
Amundi 3M	Amundi 3M - I	€30,297,084	1.87%	-0.05%	-0.00%
BNP Parvest	Diversified Dynamic	€124,087,896	7.67%	+2.90%	+0.22%
Schroders	Strategic Bond - Euro Hedged	€10,332,883	0.64%	-0.70%	-0.00%
Thesari i Republikës së Kosovës	Obligacione	€55,930,043	3.46%	+0.56%*	+0.02%
Thesari i Republikës së Kosovës	Fletobligacione	€33,808,723	2.09%	+0.07%*	+0.00%
BKT, BPB, TEB, NLB	Depozita me afat	€49,208,858	3.04%	+1.12%*	+0.03%
BQK - para të gatshme	Të painvestuara	€20,142,336	1.25%	-0.07%	-0.00%
GJITHSEJ		€1,617,279,795	100.00%	+2.23%	+2.23%

*Performanca e bazuar në norma fikse të interesit.

€36.13 MLN KTHIMI BRUTO NGA INVESTIMET

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës e përfundoi edhe tremujorin e katërt dhe gjithë vitin 2017 me kthim pozitiv nga investimet. Kthimi bruto për TM4 ishte €36.13 mln, ose një rritje e çmimit të aksionit prej 2.16%, ndërsa për vitin shkoi në €102.56 mln, ose një rritje e çmimit të aksionit prej 6.48%. Në TM4 mjetet nën menaxhim u rritën për €69.83 mln dhe arritën në €1,645.53 mln. Në rritjen e mjeteve nën menaxhim ndikuan: kthimi nga investimet (€36.13 mln) dhe kontributet e reja (€42.19 mln). Ndërkohë për të njëjtën periudhë: për pension u shpagueu €6.01 mln, për tarifa menaxhuese €1.93 mln dhe u refonduan €334.49 mijë.

FAKTORËT ME NDIKIM

Tremujori i katërt ishte ngadhënjyes sidomos për tregjet financiare të SHBA-ve, ku lehtësirat fiskale dhe treguesit e rritjes së PBB-së përtej parashikimeve nxitën tregjet drejt ngjitjeve të reja. Në anën tjetër, fuqizimi i monedhës euro ishte frenues i ngritjes së tregjeve në BE, por vazhdimi i zhvillimit ekonomik në eurozonë vazhdoi ta mbështes ngritjen e tregjeve financiare. Megjithëse BE-ja i ka zgatur afatin lehtësirave monetare deri në shtator 2018, ato do të përgjysmën në vlerë monetare, gjë që pritet të ketë efekt për kahun e lëvizjes së tregjeve këtë vit. Për të njëjtën periudhë rritje të fortë njihen tregjet financiare në zona me rëndësi, si Japonia, dhe vendet në zhvillim, duke tejkaluar parashikimet. Në TM4 nuk pati lëvizje të forta në tregun e fletobligacioneve, me luhataje të lehta pozitive në SHBA dhe me një reduktim të normave të interesit në BE.

PERFORMANCA E FONDEVE INVESTUESE

Tremujori i katërt ishte përgjithësisht pozitiv për 9 nga 12 fondet investuese të angazhuara. Ishte një lëvizje kjo që përgjithësisht ndoqi prirjen e lëvizjes së instrumenteve financiare globale, ku fondet investuese të përqendruara në aksione dhe në monedhën USD ishin në avantazh ndaj fondeve të tjera. Gjithashtu pozicionimi gjeografik dhe sektorial i investimeve luajti rol.

Edhe këtë tremujor fondi i pastër në aksione i Vanguard dëshmoi ngritje të dallueshme me fondet e tjera të angazhuara nga FKPK-ja. Performanca e këtij fondi (prej +4.76%) ishte dukshëm më e mirë sesa e tri fondeve më të afërta: fondi i aksioneve me ofrim dividendi i Pictet HDS (+3.22%); fondi në multi-asete i Schroders GDG (+3.12%) dhe fondi i fokusuar në aksione i Nordea GSEF (3.04%). Nuk ishte larg as fondi në multi-asete i BNP Parvest (+2.90%).

Tri fondet me kthim negativ për këtë periudhë ishin: fondi i bazuar në fletobligacione i Schroders SB (-0.70%); fondi i multi-aseteve i AXA WFOI (-0.27%) dhe fondi i tregut të parasë Amundi 3M (-0.05%). Ndërsa fondi i Schroders SB e kishte pengesë performancën jo të mirë të tregut global të fletobligacioneve, fondi i AXA WFOI pësoi nga përqendrimi i madh (97%) i portofolit në monedhën euro, vlerësimi i së cilës amortizoi rritjen e vlerës së fondit investues. Ndërsa fondi i Amundi 3M operon në tregun e parasë së gatshme, ku prioritet është likuiditeti dhe mbrojtja e investimeve.

Nga ana tjetër, investimet në Kosovë (në obligacione dhe fletobligacione të Qeverisë dhe në depozita bankare) ishin me norma të paracaktuara të interesit dhe kontribuan mesatarisht me 1.38% në performancën e përgjithshme të FKPK-së për këtë periudhë.

PERFORMANCA NETO E INVESTIMEVE TM4 2017

+2.16%

KRYESORET E TREMUJORIT

BORDI MBAJTI MBLEDHJEN E KATËRT PËR 2017

Bordi Drejtues, në mbledhjen e mbajtur në dhjetor 2017, ka shqyrtuar gjendjen e të gjitha investimeve dhe fondeve investuese, dhe ka marrë këto vendime: 1) Të miratohet kthimi i €385,000 nga suficiti i buxhetit për investime në fondin pensional; 2) Të depozitohen shumat në vijim në bankat lokale: BpB (€8.3 mln), BKT (€8.0 mln), TEB (€3.9 mln) dhe në NLB (€3.7 mln); 4) T'i propozohet Kuvendit të Kosovës për miratim tarifat menaxhuese prej: 0.381% për tarifën e investimeve dhe prej 0.071% për tarifën e operacioneve; 5) Të publikohet thirrja për bankat lokale për depozitim të mjeteve pensionale dhe operacionale; 6) Të iniciohet procesi për kthimin në ATK të mjeteve të pabarazuara mbi 6 vjet, sipas legjislacionit në fuqi.

KUVENDI I MIRATOI RAPORTIN VJETOR 2016 DHE TARIFAT PËR 2018

Kuvendi i Kosovës në seancën plenare të 26 janarit 2018 e ka miratuar Raportin Vjetor 2016 të FKPK-së. Njëkohësisht, në këtë seancë, Kuvendi i ka miratuar edhe tarifat e propozuara nga Bordi Drejtues i FKPK-së për vitin 2018, përkatësisht: 0.071% për tarifën operacionale dhe 0.381% për tarifën për investime. Të dy këto tarifa të propozuara janë ulur nga viti 2017, përkatësisht prej 0.081% dhe 0.393%.

KTHEHEN NË ATK €10 MLN TË PABARAZUARA

Gjatë funddhjetorit 2017 administrata e FKPK-së ka përmbyllur procesin e përgatitjes së kthimit të €9.98 mln të pabarazuara në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK). Bëhet fjalë për ato mjete që janë paguar në emër të kontributit pensional në llogarinë e FKPK-së dhe për të cilat ka qenë e pamundur të gjenden informacione në emër të kujt dhe përse janë paguar, andaj dhe kanë qëndruar të pabarazuara nëpër llogari individuale për më shumë se 6 vjet. Kthimi bëhet bazuar në legjislacionin në fuqi (Ligji Nr. 05/L -116), ku përcaktohen edhe obligimet përkatëse që mund të lindin më vonë.

RRETH 50 MIJË LLOGARI TË REJA U HAPËN KËTË VIT

Numri i llogarive të reja të hapura më 2017 u shtua për 49,612 duke e çuar kështu totalin e llogarive në 591,527 ose një rritje prej 8.4%. Njëkohësisht edhe numri i llogarive aktive ishte më i lartë këtë vit. Llogari që kishin së paku një kontribut më 2017 ishin 352,860, ndërsa më 2016 kishin qenë 312,672 sosh. Rritja e numrit të llogarive aktive më 2017 i atribuohet më së shumti mbajtjes së zgjedhjeve nacionale dhe lokale, ku angazhohen staf i përkohshëm.

€27.44 MLN PENSIONE TË TËRHEQURA MË 2017

Vlera e pensioneve të shpaguara këtë tremujor arriti në total €6.01 mln, ndërkohë që numri i llogarive të reja nga të cilat u tërhoqën mjetet numëruan 1,068. Ndërsa në nivel të vitit shuma e mjeteve të shpaguara për pension shkoi në €27.44 mln për 5,178 përfitues të pensionit, shifra këto që janë më të larta sesa më 2016, përkatësisht €19.2 mln dhe 4,445 përfitues. Prej themelimit e deri më tani për pension janë tërhequr rreth €119.2 mln për 38,560 përfitues.

SHKON NË RRETH 80 MIJË NUMRI I LLOGARIVE NË eTRUSTI

Numri i kontribuuesve që kanë hapur llogari në eTrusti deri në fund të 2017 arriti në 79,867 ose një rritje prej 5% për këtë tremujor (nga 76,096) ose një rritje prej 28% krahasuar me fundvitin 2016 (nga 62,471). Shërbimi eTrusti ofrohet falas dhe çdo kontribuues mund të hapë llogari duke vizituar adresën në vijim: <https://online.trusti.org/>

BOTUES:

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
Janar 2018

REDAKTOR:

Vërshim Hatipi

AUTOR:

Jeton Demi

KONTAKT:

Rr. "Agim Ramadani" Nr. #182-184
10000 Prishtinë

Shërbimet për klientë: +381-38-600-025
Zyra Qendrore: +381-38-600-020

info@trusti.org

www.trusti.org